

DOKUMENTACIONI PËR APLIKIMIN PËR REGJISTRIM NË STUDIMET E CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË”

Kandidatët aplikojnë për t'u regjistruar në studimet e doktoratës me dosje individuale, e cila dorëzohet në sekretarinë e njësisë kryesore dhe duhet të përmbajë dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesën e kandidatit drejtuar njësisë bazë, që është përgjegjëse për organizimin dhe administrimin e studimeve të doktoratës, ku të përfshihet fusha e studimit të doktoratës, që kërkon të ndjekë dhe drejtuesi shkencor;
2. Deklaratë e drejtuesit shkencor për udhëheqjen e studimit të doktoratës, në fushën e përzgjedhur;
3. Propozim për temën e kërkimit/metodologjinë/pritshmëritë, firmosur nga udhëheqësi;
4. Letër motivimi;
5. CV personale;
6. Lista e punimeve shkencore të dokumentuara, nëse ka të tilla;
7. Kopje të noterizuar të diplomave, të shoqëruara me suplementet e diplomës ose listën e notave me kreditet përkatëse. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të shoqërohen me vërtetimin e njohjes/ekuivalentimit nga ministria përgjegjëse për arsimin;
8. Kopje të noterizuar të diplomave të ciklit të tretë “Master Ekzekutiv“, diplomë specializimi, ose të diplomave ekuivalente me to, shoqëruar me listën e notave ose suplementin e diplomës, nëse kandidati ka të tilla;
9. Fotokopje të kartës së identitetit/pasaportës;
10. Dy fotografi;
11. Dy rekomandime nga persona me titullin akademik “Profesor” ose “Profesor i Asociuar”, ku njëri prej të cilëve duhet të mbulojë fushën përkatëse të kërkimit shkencor;
12. Vetëdeklarim ku kandidati pranon të shlyejë të gjitha detyrimet financiare të studimeve të doktoratës, sipas përcaktimeve të bëra nga UPT;
13. Dëshmi të gjuhës së huaj, sipas kornizës ligjore në fuqi;
14. Dokument të plotësimit të kriterëve specifike që ka përcaktuar njësia kryesore;
15. Vërtetim nga qendra e punës, nëse është i punësuar;
16. Mandat pagese për tarifën e aplikimit.